



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

V E N D I M

NR. 11 / 10, DATË 01 / 02 / 2023

PËR

NJË NDRYSHIM NË PROJEKTIN E INVESTIMIT STRATEGJIK
“MEDITERRANEAN WAVE” TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 11/9 DATË
02.12.2021 TË KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

Në mbështetje të Nenit 9, 17, 18, 21, 22, 24, 27 dhe 29 të Ligjit Nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Komiteti i Investimeve Strategjike,

VLERËSOI SE:

- Komiteti i Investimeve Strategjike, me vendimin Nr. 11/9 të datës 2.12.2021 "Për miratimin e statusit “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Veçantë” për projektin e investimit “Mediterranean Wave” me subjekt aplikues shoqëria “Mediterranean Wave” sh.p.k. me NUIS M11916014A", ka vendosur:
 1. *Miratimin e Statusit “Investim/Investitor strategjik procedurë e veçantë” për projektin e investimit “Mediterranean Wave”.*
 2. *Projekti “Mediterranean Wave” do të realizohet nga subjekti "Mediterranean Wave” sh.p.k. me NUIS M11916014A.*
 3. *Projekti strategjik parashikon realizimin e investimit në sektorin strategjik të turizmit.*
 4. *Projekti do të zhvillohet në Zonën Kadastrale Nr. 2909, fshati Peqinaj, Bashkia Kavajë.*

5. Në sipërfaqen totale të kërkuar prej 635,000 m², sipërfaqja totale e ndërtimit është rreth 199,668 m².
6. Statusi “Investim/Investitor strategjik procedurë e veçantë” i jepet projektit të investimit “Mediterranean Wave”, për një periudhë 4 (katër) vjeçare, përveç afatit të lejimit të përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse së plazhit si dhe afateve të lejimit të përdorimit të pasurive të paluajtshme shtetërore, të cilat vendosen me Vendim të Këshillit të Ministrave, sipas legjislacionit të investimeve strategjike.
- Me qëllim realizimin e projektit të investimit, subjektit investues iu miratuan edhe masat mbështetëse, të cilat janë reflektuar edhe në Planin e Veprimit, bashkëlidhur vendimit.
 - Më konkretisht, për masën mbështetëse *Dhënia e së drejtës së përdorimit dhe shfrytëzimit të sipërfaqes së llojit “Pyll” në pronësi Republika e Shqipërisë, me sipërfaqe 635, 000 m², e cila sipas të dhënave të kartelës së pasurisë në ASHK Kavajë ndodhet e pozicionuar në hartat me nomenklaturë K-34-99- (159- A,B,C,D) dhe mban Nr. 106/22 pasurie, volum 4 faqe 70 Zona Kadastrale 2909, Peqinaj Kavajë*, janë ngarkuar MTM dhe Bashkia Kavajë, si institucionet përgjegjëse për sigurimin e saj subjektit investues.
 - Për këtë, në pikën 10 të vendimit në fjalë, parashikohet se:

Ngarkohet Bashkia Kavajë për rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV), për përshtatjen e njësisë strukturore sipas treguesve të rinj të miratuar referuar projektit të investimit strategjik në fjalë.
 - Pika 10 e vendimit të lartpërmendur të KIS referohet në **VKM Nr. 1030, datë 16.12.2015**, respektivisht Kreu II, pika 8 ku parashikohet shprehimisht se:

“Vënia në dispozicion e pronave të paluajtshme shtetërore kryhet pasi të jetë verifikuar përputhshmëria e investimeve strategjike me dokumentet e planifikimit të territorit, si dhe me planet, politikat e strategjitë sektoriale shtetërore. Në rastet kur investimet strategjike nuk përputhen me këto plane, KIS, nëpërmjet Agjencisë, propozon përshtatjen e tyre me qëllim realizimin e investimit strategjik”.
 - Gjithashtu Pika 10 e vendimit të lartpërmendur të KIS **referohet edhe në rekomandimet e anëtarëve në grup operacional**, të cilët kanë evidentuar se projekti në fjalë duhet të përputhet me PPV Bashkia Kavajë.

Nisur nga sa më sipër, duke pasur parasysh edhe kohën e nevojshme që nevojitet për hartimin e dokumenteve të rishikimit, Komiteti i Investimeve Strategjike, pasi vlerësoi kryesisht të dhënat dhe treguesit zhvillimor të projektit të investimit strategjik, vlerëson se ai duhet të rishikohet për sa i përket gjurmës dhe sipërfaqes së propozuar për ndërtimin e tij. Për këtë arsye,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Subjekti investues "Mediterranean Wave" sh.p.k. me NUIS M11916014A të rishikojë dhe të paraqesë një gjurmë të re të ndërtimit të projektit të investimit strategjik "Mediterranean Wave", të miratuar me Vendimin Nr. 11/9 të datës 2.12.2021 "*Për miratimin e statusit "Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Veçantë" për projektin e investimit "Mediterranean Wave" me subjekt aplikues shoqëria "Mediterranean Wave" sh.p.k. me NUIS M11916014A*".
 2. Gjurma e re e rishikuar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, nuk duhet të shtrihet jashtë gjurmës së miratuar me Vendimin Nr. 11/9 të datës 2.12.2021 dhe nuk duhet të jetë më e madhe se 10 ha (100.000 m²).
 3. Gjurma e re e rishikuar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, duhet të paraqitet së bashku me Planin e Gjelbërimit, pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimit, brenda dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga njoftimi i këtij vendimi. Në rast të mosrespektimit të këtij kushti, Komiteti i Investimeve Strategjike ka të drejtë të revokojë Vendimin Nr.11/9 të datës 2.12.2021 për dhënien e statusit strategjik.
 4. Deri në përmbushjen e detyrimeve, sipas parashikimeve të këtij vendimi nga subjekti investues, efektet juridike të Vendimit Nr. 11/9 të datës 2.12.2021 të Komitetit të Investimeve Strategjike "*Për miratimin e statusit "Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Veçantë" për projektin e investimit "Mediterranean Wave" me subjekt aplikues shoqëria "Mediterranean Wave" sh.p.k. me NUIS M11916014A*", pezullohen.
 5. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

DELINA IBRAHIMAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

FRIDA KRIFCA

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

SOKOL NANO